

KËRKESË

**PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR TË MUHAMET, SAMI, FATIME, MIHASE E LUTFIJE
REXHEPIT**

GJYKATËS SË RRETHIT KAVAJË

Kërkuese: Fatmira Rexhepi e bija e Belulit dhe Nasibes, datëlindja 1963, lindur dhe banuese në lagjen nr.5 Kavajë.

Objekti: Shpalljen si të zhdukur qysh nga viti 1993 të bashkëshortit Muhamet Rexhepi, të prindërve të tij, Sami dhe Fatime Rexhepoi, si dhe të dy fëmijëve të tyre Mihase dhe Lutfije që nga viti 1993, në bazë të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëshorti im Muhamet Rexhepi që nga viti 1993 është larguar nga shtëpia në drejtim të paditur dhe që nga ajo kohë deri më sot nuk kemi asnjë informacion për vendndodhjen e tij dhe nëse është gjallë ose jo. Nga martesë me të kam fëmijët e mitur Jonida dhe Ina.

Gjithashtu, në vitin 1993 janë larguar në drejtim të paditur vjehri im Sami Rexhepi, gruaja e tij Fatime Rexhepi si dhe dy fëmijët e tyre, Mihase dhe Lutfije Rexhepi. Që nga ajo kohë edhe për këto nuk kemi asnjë informacion dhe nuk dimë, janë ose jo gjallë.

Në vështrim të nenit 15 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, personi që mungon nga vendbanimi i tij dhe për të cilin ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës. Prandaj, meqenëse për bashkëshortin, mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës. Prandaj, meqenëse për bashkëshortin Muhamed Rexhepi, vjehrin e vjehrrën, Sami e Fatime Rexhepi dhe kunatat Mihase e Lutfije nuk ka lajme për më shumë se dy vjet nga koha e largimit të tyre nga vendbanimi, kërkoj shpalljen e zhdukjes së tyre që nga viti 1993.

**KËRKUESE
Fatmira Rexhepi**